



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

---

**VENDIM**

**Nr. 80, datë 23.05.2014**

**MBI**

**MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË STATUTIN E SHOQËRISË SË SIGURIMIT  
“INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 6/gj, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” dhe të nenit 55, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e ndryshimit të nenit 20 (pika 20.1) të statutit të shoqërisë së sigurimit “Interalbanian Vienna Insurance Group” sh.a., tekstit më poshtë:

*“Neni 20*

*Përbërja dhe emërimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës*

*20.1 Këshilli mbikëqyrës përbëhet nga një numër anëtarësh nga 3 (tre) deri në 7 (shtatë). Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës caktohen nga Asambleja e Aksionarëve në përputhje me parashikimet e Ligjit Tregtar mbi kufizimet e emërimit. Këshilli Mbikëqyrës do të veprojë në përputhje me parashikimet e Ligjit Tregtar, me këtë statut si dhe me Rregulloret e Brendshme të Këshillit Mbikëqyrës, të cilat hartohen dhe miratohen nga Këshilli Mbikëqyrës”.*

2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Enkeleda SHEHI**